FAKTE PËR VAKSINËN



Shtatzania dhe Vaksina COVID-19
Pyetje të bëra shpesh

A jeni shtatzënë ose a dëshironi të bëni fëmijë në të ardhmen? Ju mund të keni pyetje për vaksinën COVID-19.

A është e sigurt për gratë shtatzëna vaksina COVID-19?

Shumë gra kanë mbetur shtatzëna dhe kanë lindur fëmijë të shëndetshëm pasi kanë marrë vaksinën COVID-19. Nuk ka prova që vaksina shkakton dështime ose probleme me pjellshmërinë për gra ose burra. Vaksina është ende në studim për gratë shtatzëna. Por ajo çka ekspertët dinë deri tani është shumë qetësuese.

Pse duhet ta marr vaksinën COVID-19 nëse jam me barrë?

Gratë shtatzëna kanë më shumë gjasa që të sëmuren rëndë nga COVID-19 krahasuar me gratë jo shtatzëna. Gratë shtatzëna që sëmuren nga COVID-19 gjithashtu kanë rrrezik më të lartë nga komplikacionet e shtatzanisë, përfshirë lindje të parakohëshme. Marrja e vaksinës COVID-19 është mënyra më e mirë për të siguruar mbrojtjen tuaj dhe të fëmijës tuaj.

Po sikur të dua të jem shtatzënë në të ardhmen?

Ekspertët e rekomandojnë fort vaksinën COVID-19 për gra shtatzëna, ato që ushqejnë me gji, që përpiqen të mbeten me barrë në periudhën e tanishme ose që mund të mbeten me barrë në të ardhmen.

Ku duhet të dreejtohem nëse do të kem pyetje të tjera?

Është krejt normale të keni pyetje. Bisedoni me mjekun tuaj për të marrë informacion të besueshëm që ju nevojitet për të marrë vendimin e duhur për veten tuaj.



Mund të mësoni më shumë tek:
mass.gov/CovidVaccineFacts